



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 dhjetor 2011
Nr. ref.: RK179/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 02/11

Parashtrues

Esat Kurtaliqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajit
C. nr. 409/06, të 7 shkurtit 2008.**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtruesi është z. Esat Kurtaliqi, me vendbanim në fshatin Pleshinë, Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston në mënyrë eksplicite Vendimin e Gjykatës Komunale të Ferizajit C. nr. 409/06, të 7 shkurtit 2008, i cili i është dërguar parashtruesit në të njëjtën datë.
3. Për më shumë, parashtruesi në kërkesën e tij po ashtu i referohet vendimit Ac.nr. 215/08 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, të 27 marsit 2009, i cili i është dërguar më 28 maj 2009.

Objekti i çështjes

4. Parashtruesi pretendon se është shkelur e drejta e tij e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 49 [e Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit].

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56(2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 10 janar 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 12 janar 2011, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.
8. Më 14 shkurt 2011, Kryetari, me Urdhrin nr. GJR. 02/11 caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Urdhrin nr. KSH. 02/11 caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Almiro Rodriguez.
9. Më 4 maj 2011, Gjykata ia komunikoi kërkesën Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, Ndërmarrjes Shoqërore IMK Fabrika e prodhimit të gypave në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: IMK) dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP).
10. Më 12 maj 2011, Gjykata ia komunikoi kërkesën Gjykatës Komunale të Ferizajit.
11. Më 23 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 27 nëntor 1989, organi i përkohshëm mbikëqyrës i IMK-së, me Vendimin nr. 5616, ka suspenduar përkohësisht parashtruesin nga puna në IMK për shkak të shkeljeve të rënda të kontratës së punës.
13. Më 12 tetor 1990, organi i përkohshëm mbikëqyrës i IMK-së ndërpreu kontratën e punës me parashtruesin me arsyetimin se ai kishte bërë shkelje të rëndë të kontratës së punës.

14. Më 26 nëntor 1990, parashtruesi u ankua në organin e përkohshëm mbikëqyrës të IMK-së lidhur me vendimin e 12 tetorit 1990.
15. Në vitin 1999, parashtruesi dhe të punësuarit tjerë të fabrikës u kthyen në punë.
16. Më 4 janar 2006, parashtruesi paraqiti ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme) duke kërkuar të konfirmohet marrëdhënia e tij e punës me IMK-në, t'i jepej kompensimi i të ardhurave personale dhe t'i ndaheshin aksionet që i ishin caktuar. Në të njëjtën ditë, dhe pas kësaj, më 14 mars 2006, parashtruesi njoftoi Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM) lidhur me ankesën.
17. Më 18 maj 2006, Dhoma e Posaçme vendosi që t'ia referojë çështjen Gjykatës Komunale në Ferizaj, si gjykatë kompetente, në pajtim me nenin 17 të Urdhëresës Administrative 2003/13 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 për themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit.
18. Më 21 nëntor 2007, AKM i dërgoi letër parashtruesit duke e njoftuar se kontrata e tij e punës me IMK ishte ndërprerë me efekt të menjëhershëm pas privatizimit të IMK-së.
19. Me vendimin C.nr. 186/05, të 7 shkurtit 2008, Gjykata Komunale e Ferizajit ndërpreu procedurën për shkak të likuidimit (apo privatizimit?) të "IMK".
20. Më 27 mars 2009, Gjykata e Qarkut të Prishtinës refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi vendimin e Gjykatës së Qarkut në Ferizaj, të 7 shkurtit 2008. Gjykata e Qarkut u shpreh se në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12), neni 9.3, "çfarëdo padie gjyqësore kundër një ndërmarrje në pronësi shoqërore që i nënshtrohet likuidimit sipas këtij neni do të pezullohet me rastin e paraqitjes së kërkesës nga Agjencia në gjykatën e vendit ku është paraqitur padia".

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi pretendon se Gjykata Komunale dhe e Qarkut kanë shkelur të drejtat e tij duke mos ia miratuar ankesën e tij për konfirmimin e marrëdhënies së tij të punës me IMK-në, duke mos ia kompensuar humbjen e të ardhurave personale dhe duke mos ia ndarë aksionet që i takonin.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Sipas pretendimeve të parashtruesit, e drejta e tij e garantuar me nenin 49 [e Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës është shkelur. Për të qenë kërkesa e pranueshme, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
23. Në lidhje me Vendimin e kontestuar C. nr. 409/06 të Gjykatës Komunale të Ferizajit, të 7 shkurtit 2008, që iu dërgua parashtruesit në datën e njëjtë, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) (h) që thotë si në vijim:

“Një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:

(h)Kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën”.

24. Në mënyrë që të vihet juridiksioni i përkohshëm i Gjykatës, është esenciale që të identifikohet, në çdo rast specifik, koha e saktë e ndërhyrjes së pretenduar. Duke vepruar kështu, Gjykata duhet të marrë parasysh të dy faktet për të cilat ankohet parashtruesi dhe fushën e të drejtës Kushtetuese që pretendohet se është shkelur (shih *mutatis mutandis*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i Dhomës së Madhe në rastin Blečić kundër Kroacisë, Parashtrës nr. 59532/0, e datës 8 mars 2006 paragrafi 82).
25. Gjykata vëren se parashtruesi ankohet që e drejta e tij për punë, e garantuar me Kushtetutë, është shkelur. Në këtë drejtim parashtruesi shprehimisht konteston vendimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, të 7 shkurtit 2008, që iu dërgua parashtruesit në të njëjtën datë.
26. Sidoqoftë, Gjykata vëren se parashtruesi u ankua në mënyrë efektive kundër vendimit të Gjykatës Komunale, në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, e cila, me Vendimin Ac. nr. 215/08, të 27 marsit 2009, vërtetoi atë vendim, por parashtruesi nuk ka treguar se ai ka dërguar një ankesë në shkallën e fundit të Gjykatës Supreme, ku ai duhet të ketë ngritur të njëjtat ankesa kushtetuese kundër vendimeve të Gjykatës Komunale dhe Gjykatës së Qarkut. Vetëm nëse ai mjet nuk do të ishte i suksesshëm, ai do të mund të parashtronte një kërkesë në këtë Gjykatë.
27. Gjykata duhet të konkludojë se parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i ka në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 (2) të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës. Arsyetimi për kërkesën e shterimit është që t’iu ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike për shkeljet e të drejtave kushtetuese (shih Aktvendim për papranueshmëri: Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtina kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 27 janarit 2010 dhe *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803194, vendimi i datës 28 korrik 1999).
28. Për arsyet e sipërpërmendura kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 47 (2) të Ligjit, dhe rregullin 36 (1) (a) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 23 nëntor 2011, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË poshtë kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani